



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministarke Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 125/2026
Datë: 26.06.2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me 22 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 2) dhe nenin 25 të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 dhe Ligjin nr. 08/L-272, në mbështetje të nenit 44 dhe 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) – Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë në detyrë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për pushimin e shërbimit të noterit

1. Znj. Arianë (Fahri) Gjoci, e emëruar noter në territorin e Komunës së Rahovecit me Vendimin nr. 217/2024 të datës 15.07.2024, i pushon ushtrimi i detyrës së noterit për shkak të dorëheqjes.
2. Shfuqizohet Vendimi nr. 217/2024 të datës 15.07.2024 për emërimin e znj. Arianë Gjoci në detyrën e noterit dhe Vendimi nr. 75/2025 i datës 26.03.2025 për fillimin e ushtrimit të detyrës së noterit.
3. Obligohet Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika në Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi me datën 01.07.2026.

A r s y e t i m

Me Vendimin nr. 217/2024 të datës 15.07.2024, znj. Arianë Gjoci është emëruar në detyrën e noterit për territorin e Komunës së Rahovecit, ndërsa me Vendimin nr.

75/2025 të datës 26.03.2025 znj. Gjoci është caktuar të filloj të ushtroj detyrën e noterit me datën 07.04.2025.

Më datë 22.06.2026 znj. Gjoci, përmes një emaili i është drejtuar Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë, ku ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga ushtrimi i detyrës së noterit me efekt nga data 01.07.2026, duke theksuar se arsyet e dorëheqjes janë: numri i madh i noterëve në komunën e Rahovecit, numri i vogël i lëndëve, të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të noterit me të cilat nuk po arrin ti mbuloj shpenzimet bazë për funksionimin e zyrës noteriale.

Andaj me që dorëheqja e saj është paraqitur në përputhje me procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, në pajtim me neni 22 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe paragrafi 2) dhe nenit 25 (paragrafi 2) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-149 dhe Ligjin nr. 08/L-272, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Donika Gërvalla-Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë në detyrë

Vendimi i'u dërgohet:

- Znj. Arianë Gjoci;
- Kabinetit të Zëvendëskryeminstres dhe Ministres së Drejtësisë në detyrë;
- Gjykatës Themelore në Rahovec;
- Odes së Noterëve të Kosovës;
- Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika.
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.